

1901
3.11.22

Nr. 10670 Prot.

Tiranë, më 01/11/2022

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Për dijeni: **Z. Adrian ÇELA**
Administrator
OSHEE Group Sh.a

Z. Elton SEVRANI
Administrator
FSHU Sh.a

Lënda: **Lidhur me aplikimin e vlerave referuese zëvendësuese për vitin 2023**

I nderuar Z. Ahmeti,

ERE me vendimin nr 28, datë 14.02.2022, vendosi “ *Pranimin e pjesshëm të kërkesës së bërë nga OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.06.2016, të bordit të ERE, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”* ”

Në zbatim të vendimit, OSSH Sh.a ka aplikuar vlera referuese Saldo për rastet e parashikuara në këtë Vendim, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE.

Situata për periudhën Shkurt – Gusht 2022, për të gjithë faturat në të cilat është aplikuar vlera referuese zëvendësuese është e paraqitur në tabelën e mëposhtme, ku është simuluar edhe sasia e kWh që do të ishin faturuar nëse do të aplikohet metodologjia e Vendimit nr. 181.

MUAJI	NR KONTRATA	KWH VENDIM NR 28	KWH VENDIM NR 181
SHKURT	15,691	4,000,139	2,549,219
MARS	10,853	2,975,210	1,727,220
PRILL	4,884	2,045,599	1,188,830
MAJ	23,297	5,087,085	3,118,479
QERSHOR	18,663	3,804,172	2,406,388
KORRIK	14,800	3,807,742	2,281,206
GUSHT	16,930	3,955,897	2,714,865
SHTATOR	14,242	4,129,893	2,842,473
Grand Total	68,412	29,805,737	18,828,680

Në të dhënat e mësipërme vihet re dukshëm një diferencë ndërmjet dy metodologjive dhe duke patur parasysh faktin se sasia e kwh të aplikuara në periudhën Shkurt-Gusht 2022 prej 25,675,844 kwh (marrë kjo në konsideratë pasi vlerat e aplikuara në shtator 2022 do të balancohen në muajt në vijim), është netuar dhe balancuar në masën 99%, kuptojmë që metodologjia e Vendimit Nr. 28 rezulton më afër trendit të konsumit dhe nëse do të kishim aplikuar metodologjinë e Vendimit Nr. 181, do të ishim shumë larg aktualitetit dhe sjelljes së këtyre konsumatorëve.

Diferenca ndërmjet dy metodologjive vjen si pasojë e disa faktorëve;

- Së pari si rezultat i diferencës së konsumit të vitit 2020 (që është një vit që përlllogaritet sipas metodologjisë së Vendimit Nr. 181), si një vit gjatë të cilit prej emergjencës kombëtare të shkaktuar nga COVID-19, kishim një renie të konsumit apo pamundësi leximi nga ana e OSSH Sh.a për një pjesë të konsumatorëve.
- Së dyti si rezultat i rritjes së konsumit për periudhën pas emergjencës së pandemisë, Vjeshtë-Dimër 2020.
- Së treti, për kontratat e reja është aplikuar mesatarja e vitit të fundit, ndërkohë që me Vendimin Nr. 181 do të faturoheshin me konsum 0.
- Së katërti kontratat të cilat nuk kanë patur një historik faturimi apo të cilat kanë patur më shumë se një vit të kaluar me konsum 0, duke përdorur metodologjinë e Vendimit Nr.28/2021, janë faturuar sipas mesatares së konsumit të vitit të fundit, që i afrohet edhe më shumë realitetit të sjelljes së këtyre konsumatorëve.

Referuar sa më sipër, si dhe duke qënë se ndryshimet e parashikuara në Vendimin Nr. 28/2021, i shtrijnë efektet juridike deri më 31 Dhjetor 2022, kërkojmë nga ana Juaj, që OSSH Sh.a të aplikojë të njëjtën metodologji për vlerat referuese zëvendësuese edhe gjatë vitit 2023.

Gjejmë rastin të risjellim në vëmendjen tuaj kërkesën tonë të ripërsëritur lidhur me ndryshimet në aktet nënligjore të cilat janë subjekt i miratimit nga ana juaj.

Referuar Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Furnizmit me energji elektrike për klientët fundorë, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, nder te tjera ne nenin 11 “Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike” dhe 12, “Faturimi i energjisë elektrike gjatë

mosfunksionimit të aparatit mates”, pika 12.2, Furnizuesit ka kompetenca, te cilat referuar Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 76, janë kompetencë e OSSH sha.

Me konsideratë,

Dhimitër KOTE

Administrator

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A

